



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KE.nr.2634/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike të paditësit Pandora A/S, me seli në Danimarkë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Vokshi&Lata, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit D.P.Z “Bylbyli”, me NUI: 810579972, me seli në Prizren, rruga “Adem Jashari” nr.2, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Durim Nevzati nga Prizreni, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë 08.12.2023, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe përfaqësuesit të palës së paditur, me datë 25.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Pandora A/S, me të cilën ka kërkuar që të konstatohet se pala e paditur D.P.Z “Bylbyli”, ka shkelur markën tregtare “Pandora”, me numër 013262, 018214 dhe 018068, si dhe t’i ndalohet të paditurit përdorimi, importimi, eksportimi, vënia në treg e çdo produkti që përmban shenjë identike apo të ngjashme me markat tregtare të paditësit.
- II. SHFUQIZOHET masa e sigurimit e caktuar me Aktvendimin KE.nr.2634/22 të datës 04.01.2023, të kësaj Gjykate.
- III. DETYROHET paditësi që të paditurit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,227.20 € në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Pandora A/S me seli në Danimarkë, përmes të autorizuarit të tij, me datën 02.11.2022, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare dhe

propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurit D.P.Z “Bylbyli”, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të konstatohet se i padituri ka shkelur markën tregtare të Pandora, me numër 013262, 018214 dhe 018068; të i ndalohet të padituri, të përdorë, të importoj, eksportoj, të hedhë në treg çdo produkt që përmban shenjë, që është identike apo e ngjashme me markën tregtare 01362, 018214 dhe 018068, të lejohej shkatërrimi i mallrave që shkelin markat tregtare të paditësit sipas numrave të lartcekur dhe të obligohet i padituri që me shpenzimet e veta ta bëjë shkatërrimin e produkteve që bartin markën tregtare Pandora, si dhe të bëjë kompensimin e dëmit në shumën e cila do të specifikohet pas pranimit të ekspertizës financiare me kamatë ligjore prej 8%, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Paditësi në padi ka deklaruar që e paditura duke vepruar me qëllime dashakeqe dhe përfitimi financiar, duke përfituar nga marka e paditësit, ka përdorur pa autorizim markën e kompanisë Pandora, duke tregtuar produkte të falsifikuara dhe përmes shitjes së produkteve të falsifikuara, ka dëmtuar imazhin e paditësit dhe markën e tij me renome botërore. Me shitjen e produkteve të falsifikuara e paditura i ka shkaktuar dëm paditësit, si dhe me shpalesjen e produkteve me karakteristikat e brendit Pandora, ka shkelur të drejtat e mbrojtura të paditësit sipas Ligjit për nr.08/L për Markat Tregtare (tutje LMT), si dhe ka cenuar specialitetin dhe garancinë e markës së paditësit, ngase produktet e të paditurës përmbajnë markën e saj tregtare, por nuk kanë karakteristikat, përbërjen dhe cilësinë, të cilat kanë produktet e saj.

Gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e paditësit, A.A.A., ka deklaruar se tërhiqet nga kërkesa sipas pikës IV të padisë e cila ka të bëjë me lejimin e shkatërrimit të mallrave kontestuese, ndërsa pikën V të kërkesës e ka precizuar në atë mënyrë që ka këkuar nga gjykata që në emër të gjobës për shkeljen e markës tregtare të paditësit, t'i shqiptojë të paditurës gjobën në vlerë prej 10.000 Euro në favor të pronarit të markës tregtare, ndërsa ka mbetur pranë kërkesëpadisë sipas pikave I, II, III dhe VI të padisë, duke theksuar që në rastin konkret nuk është kontestuese se e paditura e ka shkelur markën tregtare të paditësit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesa e paditësit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri me përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar që në rastin konkret mënyra se si janë rradhitur fotografitë e dorëzuara si provë me produktet e gjetura, nuk mbajnë asnjë datë, asnjë veprim, dhe asnjë konkretizim. Sa i përket këtyre fotografive konsiderojmë se përveç mos lejueshmërisë në aspektet ligjore të kësaj prove, meqenëse nuk mund të verifikohet se nga kush janë bërë këto fotografi dhe nuk dihet se ku janë bërë këto fotografi, e njejta edhe provueshmërinë e ka në dyshim. Më tutje ka theksuar që në fotografitë e paraqitura ku është paraqitur edhe një kartë-vizitë dhe një bizhuteri të cilën paditësi pretendon që e mban markën tregtare të mbrojtur, konsiderojmë që këto prova janë të papranueshme për shkak se asnjë logjikë juridike nuk e përcakton dhe nuk tregon se ky produkt me të vërtetë qenka tregtuar nga ana e të paditurit. Ka shtuar se me provat e paraqitura të cilat janë të njëanshme dhe nuk janë prova, shkeljet e markës tregtare i konstatojnë organet shtetërore dhe jo pala në mënyrë të njëanshme me pretendimet e saj me provat e parashtruara. Në fund ka theksuar që kjo padi dhe kërkesëpadi është e paprovuar, andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi, si dhe të shfuqizohet masa e sigurimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar dhe atë: për përfaqësim në tri seanca shumë prej 811,20 € (270.40x3), për përgjigje në padi shumë prej 208.00 €, për ankesën e datës 26.01.2023 shumë prej 208.00 €, në shumë të përgjithshme prej 1,227.20 €.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim:

Aplikacioni i regjistrimit të markës tregtare me Nr.KS/M 2014/000098, Aplikacioni i regjistrimit të markës tregtare me Nr.KS/M 2014/000442, dhe Aplikacioni i regjistrimit të markës tregtare me Nr.KS/M 2010/001191, të datës 27.10.2022, Kërkesa me NRF. 22-488540-KO, e datës 17.03.2022, të paditësit drejtuar të paditurit lidhur me shkeljen e të drejtave për shkeljen e pronësisë intelektuale, si dhe shikimin e foto dokumentacionit në përbërje prej 5 fotografive.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas Aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare Nr.013262, të datës 09.03.2014, Aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare Nr.018068, të datës 04.12.2015, dhe Aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare Nr.018214 të datës 17.12.2015, vërtetohet se paditësi e ka regjistruar pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare verbale “PANDORA”, dhe markës tregtare verbale “ALE”, si dhe i njëjti është bartës i të drejtave të këtyre markave tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasa 14 dhe 35 të Klasifikimit të Nicës, dhe nga Klasa 531 të Klaisifikimit të Vjenës.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, meqenëse paditësi në rastin konkret nuk ka arritur të vërtetoj pretendimin e tij, se i padituri mban produktet e markës tregtare të paditësit.

Gjykata deri tek ky konstatim ka arritur nga provat e administruara, e nga të cilat nuk është arritur të vërtetohet pretendimi i paditësit për shkeljen e markës së tij tregtare nga ana e të paditurit. Pavarësisht faktit që paditësi si bartës i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare dhe se përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare, në rastin konkret nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga foto dokumentacioni i dorëzuar i cili përmban një foto të lokalit të të paditurit dhe disa foto të produkteve të paditësit, nuk mund të vërtetohet se të njëjtat kanë qenë produktet të cilat i padituri i ka vendosur në treg, nuk mund të vërtetohet se produktet e paraqitura në fotot e lartcekura janë gjendur në lokalin e të paditurit, përkatësisht se i njëjti i ka vënë në qarkullim këto produkte, për të cilat pretendohet shkelja e markës tregtare.

Sipas nenit 7 të LPK-së, i cili përcakton detyrimin e palëve për vërtetimin e fakteve mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre dhe nenit 319 të LPK-së i cili përcakton se secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta gjykata vlerëson se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të argumentonte pretendimin e tij edhe pse sipas dispozitave të sipërcituara i njëjti ka pasur për obligim të siguroj prova, në mënyrë që të i provojë pretendimet e veta, përkatësisht se i padituri mban produkte të markës tregtare të paditësit.

Me nenin 9 par.1 të Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, është përcaktuar se “ *Inspektorati i tregut ka për kompetencë që të inspektojë standardet e tregtimit të mallrave dhe të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë subjektet ekonomike në territorin e Republikës së Kosovës, duke e mbikëqyrë:*”, ndërsa në pikën 1.9 të këtij neni, parashihet mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale në treg.

Sipas nenit 19 par.1 të Ligjit Nr. 03/L-181 Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut përcaktohet se “ *Inspektori ndërmerr masat për procedurën inspektimit sipas detyrës zyrtare, por edhe në bazë të ankesës së palës së tretë*”, me par. 2 të këtij neni përcaktohet se “ *Ankesën e palës së tretë, Inspektori është i obliguar ta merr në konsiderim vetëm nëse ankesa paralajmëron shkelje të dyshuar për të cilën parashihet inicimi i procedurës sipas detyrës zyrtare.*”, ndërsa në par.3 të këtij neni është përcaktuar që “ *Inspektori është i detyruar që konform paragrafit 2, të këtij neni të informojë parashtruesin e ankesës lidhur me gjendjen e konstatuar, respektivisht masat e ndërmarra në afatin ligjor.*”

Pavarësisht faktit se procedura për konstatimin e shkeljeve të pronësisë industriale pranë Inspektoratit të Tregut, nuk përbën obligim për palën e cila pretendon se i është shkelur e drejta, bazuar në dispozitat e sipërcituara, rezulton se në rast të evidentimit të shkeljeve të të drejtave të pronësisë industriale, paditësi ka pasur të drejtën e paraqitjes së ankesës pranë Inspektoratit të Tregut, për konstatimin e shkeljeve të tilla, e të cilat konstatime do të mund t’i shërbenin paditësit për vërtetimin e pretendimeve të paraqitura me padi dhe do të mund të krijonin ose vërtetonin bazueshmërinë e kërkesës së tij.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe kërkesën e datës 17.03.2022, Nr. Ref 22-488551-KO, përmes së cilës është pretenduar se paditësi i është drejtuar të paditurit lidhur me shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale, mirëpo gjeti se e njëjta nuk ka ndikim për vendosje në këtë çështje kontestimore, për faktin se nuk është dëshmuar me asnjë provë se kjo kërkesë është pranuar nga i padituri në çfarëdo forme.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata gjeti se kërkesëpadija e paditësit, rezulton si e pa bazuar, meqenëse nga gjendja faktike e vërtetuar, nuk mund të konstatohet se i padituri ka shkelur

markën tregtare të paditësit, meqenëse nuk janë ofruar prova përmes së cilës do të vërtetoheshin pretendimet e paditësit në rastin konkret.

Gjykata duke u bazuar në nenin 309 par. 1 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Masa e sigurimit e caktuar me vendim të gjykatës mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit”*, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe shfuqizoi masën e sigurimit, pasi që ka konstatuar se kanë pushuar arsyet për të cilat është caktuar kjo masë siguroese.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 dhe nenit 453 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit, i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga i padituri dhe atë: për përfaqësim në tri seanca shumën prej 811,20 € (270.40x3), për përgjigje në padi shumën prej 208.00 €, për ankesën e datës 26.01.2023 shumën prej 208.00 €, në shumën e përgjithshme prej 1,227.20 €.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2634/22, me datë 25.12.2023

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.